



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës së Dragashit Uran Halimi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Dragashit
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Dragashit
Lloji i aktit:	Vendimi nr. 060-101-3947/22/6

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 28.03.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin Nr. 060-101-3947/22/6, për publikimin e listave të pronave të paluajjtshme të komunës për vitin 2022, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Dragashit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

Vendimin Nr. 060-101-3947/22/6, për publikimin e listave të pronave të paluajjtshme të komunës për vitin 2022, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur me datë 10.03.2022, ka miratuar Vendimin Nr. 060-101-3947/22/6, për publikimin e listave të pronave të paluajjtshme të komunës për vitin 2022.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Dragashit është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 13 të Ligji nr. 06/I-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Dragashit me datë 10.03.2022, me 26 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendimin Nr. 060-101-3947/22/6, për publikimin e listave të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2022 me qëllim që komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Me datën 17 Tetor 2021 janë mbajtur zgjedhjet lokale në tërë Republikën e Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj ka vazhduar konstituimi i organeve lokale, një numër i komunave i është pamundësuar planifikimin dhe publikimin me kohë të listës së pronave. Duke parë këtë situatë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka dërguar shkresën nr. 463-36 të datës 13.01.2022 në komuna me të cilën ka caktuar afatin shtesë për caktimin për publikimin e listës së pronave deri me datën 31.03.2022. Andaj duke u bazuar në shkresën e MAPL-së për afat shtesë organet e komunës së Dragashit kanë miratuar Vendimin Nr. 060-101-3947/22/6, për publikimin e listave të pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2022.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Bexhet Xheladini, gradonačelnik opštine Dragaš Uran Halimi, predsedavajuća Skupštine opštine Dragaš	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-a Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a Venera Çerkini, zamenica generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Datum: 06.04.2022 br. 020-251/3
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:		
2. Službenik-ca za izradu pravne procene:	Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Dragaš	
Vrsta akta:	Odluka br. 060-101-3947/22/6	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa članom 81.4 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmenidopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, MALS je od 28.03.2022.godine, primilo radi procene zakonitosti Odluku br. 060-101-3947/22/6, o objavljivanju spiskova nepokretne opštinske imovine za 2022.godinu, usvojenju od strane Skupštine opštine Dragaš.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS) je razmotrilo zakonitost dotičnog akta, i:

POTVRĐUJE

Odluka br. 060-101-3947/22/6, o objavljivanju spiskova nepokretne opštinske imovine za 2022.godinu, *je u skladu* sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Dragaš na sednici održanoj datuma, 10.03.2022.godine, usvojila je Odluku br. 060-101-3947/22/6, o objavljivanju spiskova nepokretne opštinske imovine za 2022.godinu.

MALS, konstatuje da je usvojena odluka, od strane Skupštine opštine Dragaš zasnovana na članu 12 Zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi, na članu 13. Zakona br. 06/1-092 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine. Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Dragaš dana, 10.03.2022.godine, sa 26 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih glasova. Odluka br. 060-101-3947 / 22/6, o objavljivanju spiskova nepokretne opštinske imovine za 2022. godinu, u cilju kako bi opština objavila opšti spisak nepokretne opštinske imovine, kao i poseban spisak nepokretnosti koje se planiraju dati na korišćenje za narednu godinu do 31. decembra, opravdavajući javni interes i ekonomski razvoj opštine.

Dana 17. oktobra 2021. godine održani su lokalni izbori širom Republike Kosovo i kao rezultat toga, nastavljeno je konstituisanje lokalnih organa, jedan broj opština je bio sprečen da planira i blagovremeno objavi spisak imovine. Sagledavajući ovakvu situaciju, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je uputilo dopis br. 463-36 od 13.01.2022.godine u opštinama kojima je određen dodatni rok za određivanje za objavljivanje imovinskog spiska do 31.03.2022. Stoga, na osnovu dopisa MALS-a za dodatni rok, organi opštine Dragaš su usvojili Odluku br. 060-101-3947/22/6, o objavljivanju spiskova nepokretne opštinske imovine za 2022. godinu.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.